



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 06/L -112

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR FINANCIM MIDIS
REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE ASOCIACIONIT
NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIM PËR PROJEKTIN E
EKONOMISË DIGJITALE TË KOSOVËS**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR FINANCIM MIDIS
REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE ASOCIACIONIT
NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIM PËR PROJEKTIN E
EKONOMISË DIGJITALE TË KOSOVËS**

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim që të ratifikojë Marrëveshjen për Financim midis Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Ekonomisë Digjitale të Kosovës.

Neni 2
Ratifikimi i Marrëveshjes

Nëpërmjet këtij ligji ratifikohet Marrëveshja për Financim midis Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Ekonomisë Digjitale të Kosovës, e nënshkruar më datë 20.07.2018.

Neni 3
Dokumentet e bashkëngjitura

Në Shtojcën e këtij ligji është e bashkëngjitur Marrëveshja për Financim midis Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Ekonomisë Digjitale të Kosovës, e nënshkruar më datë 20.07.2018.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 06/L -112
20 shtator 2018

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kadri VESELI